



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

L I C E N C Ë
Nr. 38, datë 09.05.2016

PËR TË VEPRUAR SI SUBJEKT FINANCIAR JOBANKË
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"; si dhe rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka" miratuar me vendim nr.01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë i jep shoqërisë "MICRO CREDIT ALBANIA" sh.p.k. licencën për të kryer veprimtaritë financiare të përshkruara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme.

GENT SEJKO

GUVERNATOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Tiranë më 09.05.2016

ANEKS
LICENCA NR. 38

VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR "MICRO CREDIT ALBANIA" SH.P.K.

Subjekti financiar jobankë "MICRO CREDIT ALBANIA" sh.p.k. në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka" miratuar me vendim nr.01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, është i licencuar të kryejë veprimtaritë financiare si më poshtë:

- 1) Të gjitha format e kredidhënies,
- 2) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtarinë e kredidhënies.

GENT SEJKO

GUVERNATOR